R E L A C I O N
mbi

VENDIMIN

“PËR BUXHETIN 2026”

Sarande, Dhjetor 2025

HYRJE

Buxheti vjetor i Bashkisë Sarandë për vitin 2026, përfaqëson dokumentin themelor të politikave financiare dhe zhvillimore të njësisë sonë të vetëqeverisjes vendore. Ky buxhet përcakton planin e të ardhurave dhe të shpenzimeve për periudhën fiskale 2026, duke orientuar përdorimin e burimeve publike në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, rritjes ekonomike dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve të Bashkisë Sarandë.

Hartimi i buxhetit është realizuar në përputhje me Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",) Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Udhezimit nr 8 date 28.02.2025, dhe udhezimit plotesues Nr.19 date 10.07.2025 "Per pregatitjen e PBA 2026-2028" të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Procesi i përgatitjes është zhvilluar në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke përfshirë konsultime me njësitë administrative, komunitetin, bizneset lokale dhe grupet e interesit, me qëllim që buxheti të pasqyrojë nevojat dhe prioritetet reale të territorit dhe banorëve.

Buxheti 2026 fokusohet në rritjen e të ardhurave vendore, përmirësimin e infrastrukturës urbane dhe turistike, zgjerimin e shërbimeve publike cilësore dhe mbrojtjen e mjedisit bregdetar. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar projekteve që lidhen me zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, përmirësimin e sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, rehabilitimin e hapësirave publike dhe rritjen e aksesit në shërbime për komunitetet rurale të Bashkisë.

Pavarësisht sfidave që lidhen me ruajtjen e balancës fiskale dhe rritjen e kërkesave për investime publike, Bashkia Sarandë mbetet e përkushtuar për një menaxhim të përgjegjshëm, transparent dhe eficient të financave publike. Synimi ynë është të sigurojmë që çdo lek i taksapaguesve të përdoret me përgjegjësi për të sjellë përfitime konkrete për qytetarët dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit tonë.

Parimet bazë të hartimit të buxhetit te bashkise per vitin 2026;

1. Balancimi i të ardhurave dhe shpenzimeve
   – Buxheti duhet të jetë i ekuilibruar: shpenzimet nuk mund të tejkalojnë të ardhurat e pritshme (përveç në rastet e investimeve me hua të miratuara).
2. Efikasiteti dhe ekonomiciteti
   – Fondet publike duhet të përdoren në mënyrë sa më efikase, me kosto të ulët dhe përfitim maksimal për komunitetin.
3. Transparenca dhe llogaridhënia
   – Procesi i buxhetimit duhet të jetë i hapur për qytetarët, me publikime dhe konsultime publike.

4. Pjesëmarrja qytetare
   – Qytetarët, bizneset, dhe grupet e interesit duhet të kenë mundësi të japin mendime dhe propozime për prioritetet e shpenzimeve.
5. Qëndrueshmëria financiare
   – Buxheti duhet të sigurojë stabilitet afatgjatë, pa krijuar borxhe të pamenaxhueshme.

Politikat e të ardhurave

- Rritja e të ardhurave vendore përmes:
  - Administrimit më të mirë të taksave dhe tarifave lokale (p.sh. taksa mbi pasurinë, tarifat e pastrimit, etj.).
  - Zgjerimit të bazës së tatimpaguesve.
  - Luftës kundër informalitetit fiskal.
- Diversifikimi i burimeve të të ardhurave.
- Transparencë në politikat fiskale – çdo ndryshim në taksa ose tarifa do të jetë i argumentuar dhe i konsultuar me komunitetin.

Politikat e shpenzimeve

- Prioritet për shërbimet bazë publike (arsimi, shëndetësia parësore, pastrimi, ndriçimi publik, infrastruktura).
- Orientim do te jete drejt investimeve kapitale, që krijojnë zhvillim afatgjatë (rrugë, sherbime, kanalizime, etj.).
- Kufizimi i shpenzimeve operative (paga, energji, qira, etj.) për të rritur investimet produktive.
- Barazia territoriale dhe sociale – shpërndarja e fondeve duhet të jetë e drejtë midis njësive administrative dhe shtresave të popullsisë.
- Zbatimi i parimit të performancës – çdo program buxhetor do të ketë objektiva të matshme dhe tregues rezultati.

Procesi i hartimit te buxhetit, paraqet në mënyrë të ndërthurur informacionin mbi parashikimet e të ardhurave, dhe përcakton objektivat se si do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofroje Bashkia.

Hartimi i nje buxheti efikas per pushtetin vendor perfshin nje proces te strukturuar qe bazohet ne nje analize te kujdesshme dhe planifikim te qarte, referuar ne prioritetet e komunitetit, dhe ne perputhje me planet strategjike lokale dhe kombetare.

Ne procesin e hartimit te buxhetit te investimeve publike jane mbajtur parasysh prioritetet e projekteve qe ndikojne drejtperdrejt ne zhvillimin e komunitetit dhe permiresimin e cilesise se jeteses.

Me këtë buxhet, Bashkia Sarandë vijon vizionin e saj për ndërtimin e një qyteti modern, të pastër, tërheqës dhe mikpritës, që ruan identitetin e vet kulturor dhe natyror, duke u konsoliduar si një nga destinacionet turistike më të rëndësishme të Rivjeres Shqiptare.

Faleminderit!

KRYETAR

Oltion ÇAÇI

TREGUESIT KRYESOR TË BUXHETIT TE BASHKISE SARANDE

Burimet e të ardhurave vendore

Të ardhurat e pushtetit vendor ndahen në dy kategori kryesore:

A. Të ardhurat e veta vendore:

- Taksa mbi pasurinë e paluajtshme (banesa, truall, objekte biznesi)
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
- Taksa e fjetjes në struktura akomoduese
- Taksat mbi biznesin e vogël lokal
- Të ardhurat nga tarifat dhe shërbimet publike (ujë, pastrim,ndricim, tregje, parkime etj.)
- Qiradhëniet, gjobat dhe të ardhurat nga pronat e bashkisë

B. Të ardhurat nga burime të ndara dhe transfertat:

- Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit
- Transferta të kushtëzuara për programe dhe projekte specifike
- Grantet dhe donacionet e institucioneve ndërkombëtare

Metodologjia e parashikimit

Parashikimi i të ardhurave është kryer mbi bazën e:

- Analizës historike të të ardhurave për tre vitet e fundit;
- Tendencave ekonomike në territorin vendor (p.sh. zhvillimi i turizmit, ndërtimit, tregtisë);
- Ndryshimeve ligjore në taksa dhe tarifa;
- Planit të zhvillimit vendor dhe projekteve të planifikuara;
- Treguesve makroekonomikë kombëtarë, si inflacioni dhe rritja ekonomike.

Per rritjen e kapacitetit fiskal;

- Bashkia do te vijoje permiresimin e administrimit fiskal dhe evidentimin e pasurive.
- Do te forcohet bashkepunimi me Drejtorine e Tatimeve dhe ASHK per zgjerimin e bazes tatimore
- Do te zbatohen masa per rritjen e arketueshmerise se tarifave dhe taksave vendore
- Do te merren masa per te ulur informalitetin dhe evazionin fiskal

A) PARASHIKIMI I TE ARDHURAVE TE VETA VENDORE

Programimi i të ardhurave për vitin 2026, eshte mbeshtetur ne ecurine e realizimit te te ardhurave ne terma afatmesem, potencialin ekonomik te bashkise Sarande dhe rritjen e sipermarrjes private. *Burimet financiare* per buxhetin e Bashkise perbehen; nga (i) burimet e veta vendore, (ii) nga transferta e pakushtezuar (iii) transferta e pakushtezuar sektoriale,(iv) nga transfertat nga buxheti i shtetit per projekte te investimeve.

Bazuar në legjislacionin tatimor dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, për mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, pjesë e paketës fiskale të Bashkisë Sarande, janë përcaktuar edhe strukturat përkatëse për mbledhjen e tyre, si më poshtë:

- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore;
- Strukturat e Aparatit të Bashkisë;
- Agjentët tatimorë.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, është struktura kryesore për mbledhjen dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave të Bashkisë, e cila administron plotësisht procesin e mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifat vendore për kategorinë e bizneseve, si dhe arkëton dhe ndjek procesin e rakordimit për të ardhurat që mblidhen nga struktura të tjera të Bashkisë dhe nga Agjentët Tatimorë.
- Strukturat e Aparatit të Bashkisë janë të angazhuara në administrimin e tarifave të shërbimit që aplikon vetë institucioni si dhe në taksat që zbatohen direkt prej tyre, arkëtimi i të cilave bëhet me tej nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

- Agjentët tatimorë të përcaktuar sipas ligjit dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, janë:

- DRSHTRR, për arkëtimin e taksës vjetore të mjeteve të përdorura;
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për arkëtimin e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
- Drejtoria Rajonale Tatimore, për arkëtimin e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin e BV; (tashmë prej vitit 2021 vetëm për pjesën e detyrimeve të prapambetura)
- Ujësjellës Kanalizime Sarande Sha, për arkëtimin e taksës së ndërtesës, dhe tarifës së pastrimit nga kategoria Familjarë;

Niveli i parashikuar i te ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore eshte **ne 923,469 mije lek**, me nje rritje prej 13% krahasimisht me parashikimin ne buxhetin e vitit 2025.

Ne perberjen e buxhetit nga te ardhurat e veta te Bashkise Sarande, kontriubojne ;

- ✓ Te ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore me peshe prej 52% te totalit te te ardhurave buxhetore.
- ✓ Te ardhura nga transfertat e pakushtezuara zene rreth 26 % te totalit te buxhetit.
- ✓ Te ardhurat e paperdorura nga viti aktual zene rreth 22% te totalit te buxhetit.

Totali i te Ardhurave Buxhetore per vitin 2026 eshte parashikuar ne vleren e **1,865,717 mije lek**.

Struktura e te ardhurave perbehet prej;


a) Te ardhurat e veta (taksa tarifa)
b) Te ardhurat nga grantet (transfertat e pakushtezuara)
c) Te ardhurat e deleguara (transfertat e pakushtezuara sektoriale)

Per vitin 2026 parashikimi i te **ardhurave nga taksat dhe tarifat** eshte ne vleren **923,469 mije lek,** me nje rrijte prej 13% dhe **Te ardhura nga burime qendrore,** te pakushtezuara jane rritur me 10% ne raport me grantet e pakushtezuara per vitin 2025.

Një pasqyrim në vija të përgjithshme i parashikimit të <u>të ardhurave te nga taksat dhe tarifat vendore</u> për periudhen afat mesme jane parashikuar me rritje prej 28% ne raport me parashikimin e vitit 2025, ku mund të shihet në tabelën më poshtë:

ne 000/lek

nr	Te ardhurat vendore	Plan 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
A	Nga burimet e veta vendore	815,131	923,469	976,123	1,046,023
B	Te ardhura te trasheguara nga viti i meparshem	390,000	450,000	390,000	390,000
D	Te ardhura nga burime qendrore te pakushtezuara	447,957	492,248	509,094	527,206
	Transferta e pakushtezuar	301,873	331,100	347,946	366,058
	Transferta e pakushtezuar sektoriale	146,084	161,148	161,148	161,148
	Totali	1,653,088	1,865,717	1,875,217	1,963,229



Struktura dhe ecuria ne realizimin e burimeve vendore në periudhën afatmesme 2026-2028 evidenton qendrueshmerine dhe trendin pozitiv ne terma te pergjithshem, me rikuperimin edhe te treguesve negative makroekonomike te viteve te fundit. Referuar pritshmerise se realizimit te te ardhurave vendore per vitin 2025, ku kontributori kryesor ka qene sektori i turizmit , te ardhurat priten me realizim te parashikimit buxhetor. Treguesit makroekonomike tegojne se ekonomia kombetare pati rritje te ndjeshme, duke reflektuar edhe ne ekonomine vendore nepermjet rritjes se granteve qeveritare. Rritja e te ardhurave nga turizmi kane arritur qendrueshmeri per vitin 2025,

gje e cila e klasifikon kete industri jo vetem si shtyllen kryesore te ekonomise, por edhe nje garanci qendrueshmerie buxhetore ne qeverisjen vendore.

Nderkohe, persa u perket zerave te vecante ne perberje te taksave dhe tarifave, eshte bere e mundur nje parashikim racional me paqendrueshmeri te moderuara nga viti ne vit, qe ne terma te pergjithshem te ardhurat vendore paraqiten me trend rrites.

Trajtimi ne periudha afatmesme te ecurise se realizimit ze per ze dhe ne total te te ardhurave ekspozon qasjen pozitive të rritjes së peshës specifike të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore ne totalin e buxhetit vendor. Raporti per periudhen e parashikuar ne buxhet per vitet 2026- 2028 i te ardhurave vendore eshte parashikuar te kete rritje me rreth 13% dhe persa i perket raportit te transfertave te pakushtezuara per te njejten periudhe rritja eshte me rreth 6%.

Transferta e pakushtezuar per vitin 2026 eshte parashikuar ne rritje me 10% ne raport me nje vit me pare. Rritja e fondit te pakushtezuar do te shkoje ne mbulimin hendekut ndermjet kostos te sherbimeve publike dhe te ardhurave te relizuara nga te ardhurat e taksa- tarifave nga bashkia, dhe ne masen 40%, do te kanalizohet per investime kapitale.

Transferta e pakushtezuar sektoriale eshte parashikuar ne rritje me 10% ne raport me nje vit me pare, te cilat do te shkojne ne mbeshtetje te sektoreve te arsimit, bujqesise dhe te mbrojtjes nga zjarret.

Transferta e kushtezuar Fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara, *nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të njësive vendore*, por reflektohen në dokumentin e realizimit të buxhetit, si fonde të administruara nga njësitë vendore.

Sipas akteve ligjore në fuqi, funksione të deleguara në pushtetin vendor janë si më poshtë, por nuk kufizohemi vetëm në ato të cituara:

- *Shërbimi i gjendjes civile* si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative bëhen nga bashkitë, në bazë të udhëzimeve që bëhen nga Ministria e Brendshme. Numri i punonjësve dhe fondet përkatëse për këtë funksion përcaktohen nga Ministria e Punëve të Brendshme.
- *Përkrahja sociale*, si funksion i deleguar i detyrueshëm, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale detajon në fillim të vitit fondet për përkrahjen sociale për çdo njësi të qeverisjes vendore, në mënyrë specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën per ndihma ekonomike dhe paaftesi.
- *Te ardhurat e paperdorura* përfaqësojnë ato fonde (likuiditete), të cilat janë gjëndje në fund të vitit buxhetor dhe nuk arrijnë të shpenzohen brenda këtij vitit për arsye te ndryshme si psh: tejkalimi të realizimit të të ardhurave, mos realizimi të shpenzimeve të planifikuara, të tjera të cilat afektojnë dinamikën e vitit si psh. ndryshimet në legjislacion.

Fondi i planifikuar për t'u mbartur për vitit 2026 nga Bashkia Sarande është 450,000 mije lekë. Arsyet që afektojnë mbartjen janë si më poshtë: (i). Realizimi i të ardhurave: për vitin 2025, të

ardhurat e Bashkisë së Sarandes janë me tejkalim kundrejt planit të miratuar. Deri në mesin e muajit Nëntor të ardhurat janë tejkaluar 70,000 mije lek lekë, 111 %. Pritshmëritë deri në fund të vitit janë që, tejkalimi të ardhurave të jetë në vlerën 80,000 mije lekë. (ii). Realizimi i shpenzimeve: për periudhen Janar – Tetor 2025 treguesit e realizmit të buxhetit janë në vlerën 52% nga të ardhurat dhe transferta e përgjithshme dhe ajo sektoriale. Referuar një prognoze të kryer për muajt nëntor – dhjetor 2024 duke marë në konsideratë dhe % e realizimit të dy mujorit të fundit të vitit të kaluar, pritet një realizim i buxhetit deri në 80% të planeve të miratuara.

A.1) Te ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

Parashikimi buxhetor i te ardhurave vendore behet ne zbatim te ligjit 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", mbeshtetur ne paketen fiskale per vitit 2026, ne perberje te se ciles jane, lloji i taksave, tarifave, baza e taksueshme, kategorite e bizneseve dhe kestet e pagesave pergjate gjithe vitit, si dhe menyren e vjeljes se tyre.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore per vitin 2026 jane perllogaritur ne vleren 923,469 mije lek, me një rritje prej 13% krahasuar me planin fillestar të vitit 2025 duke mbajtur keshtu nje stabilitet pas rritjes se konsiderueshme ne vitin 2024 ne rreth 40% ne raport me parashikimin fillestar te te ardhurave ne buxhetin 2023. Në rritjen e parashikimit ndikojnë disa elementë si më poshtë:

- Së pari, per kategorine e takses se nderteses (per banesat dhe njesite tregetare) eshte zgjeruar baza e taksueshme duke saktesuar siperfaqet e cila ka cuar ne rritjen e te ardhurave masen 20%.
- Se dyti, taksa e fjetjes ne hotel eshte rritur ne masen 15% ne raport me vitin 2025, si efet i rritjes se bazes se taksueshme, efekt i uljes se informalitetit dhe kategorizimin e hoteleve sipas zonave.
- Se treti, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja vazhdon të jetë një prej elementëve më të rëndësishëm të të ardhurave për Bashkinë Sarande. Për vitin 2026 parashikimi eshte bere ne te njejtat nivele krahasimisht me fillim vitin 2025.
- Së katerti, taksa e zenies se hapesires publike eshte parashikuar ne masen 24% me lart se parashikimi ne fillim te vitit 2025, per arsyen e parashikimit ne rritje te kerkesave per siperfaqeve te kontraktuara.
- Së pesti, tarifa e sherbimit ne familjare eshte parshikuar 11 % me shume se parashikimi 2025 per efekt te rritjes se synuar te bazes se taksueshme nepermjet uljes se informalitetit ne kategorine biznes dhe familjare.
- Te ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore kane evidentuar rritje progresive dhe ne raport me buxhetin, perfshire edhe transferten e pakushtezuara perbejne 70% te totalit te buxhetit nga te ardhurat e veta. Në fund të vitit 2024, realizimi i planit ne buxhetit nga të ardhurat e burimeve te brendshme vendore (taksa dhe tarifa vendore, veprimtari me asete dhe të tjera) pritet te realizoje parashikimin buxhetor vjetor duke diktuar edhe rritjen e parashikimit buxhetor 2025.

  Te dhenat baze per parashikimin e te ardhurave jane referenca kryesore per parashikimet e tavaneve buxhetore afatmesme. Gjate periudhes se hartimit te buxhetit vjetor 2026, u moren disa masa nga bashkia per te saktesuar bazen e te dhenave, per te ulur informalitetin dhe per te bere te mundur garantimin e taksimit te drejte dhe te ndershem per te gjitha kategorite.

Gjithashtu parashikimi buxhetor i te ardhurave eshte bazuar edhe në analizën e trendit të te ardhurave te taksave dhe tarifave, për një periudhë afat mesme. Ky parashikim është korrektuar me efektet e faktorëve të tjerë të jashtëm për secilin ze te ardhurash.


Faktorët e jashtëm qe ndikojne në parashikimin e të ardhuravene Bashkine Sarande për vitin 2026 janë:

i. **Situata Makroekonomike.** Duke qene se buxheti qendror luan nje rol te rendesishem ne buxhetin lokal, nepermjet alokimit te fondeve per veprimtari te caktuar te ekonomise vendore, nje rritje ose tkurrje e ekononise kombetare sikunder ka ndodhur ne vitet e fundit jep efektet e saj edhe ne Buxhetin Vendor.

ii. **Politikat fiskale.** Ndryshimet e mundshme ne paketen fiskale apo ne kuadrin ligjor per taksat dhe tarifat vendore do te reflektohen edhe ne te ardhurat vendore .

Një pasqyrim në vija të përgjithshme të të ardhurave për periudhen 2025-2028 mujore, mund të shihet në tabelën më poshtë:

nr	Te ardhurat nga taksat dhe tarifat	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
1	Te ardhurat nga taksat vendore	547,036	635,602	677,779	736,139
2	Te ardhurat nga tarifat	232,595	252,967	264,445	276,485
3	Te ardhura te tjera	35,500	34,900	33,900	33,400
	Totali	**815,131**	**923,469**	**976,123**	**1,046,023**



E pare sipas struktures, performanca pozitive e të ardhurave nga burimet e veta është përcaktuar kryesisht nga kontributi i të ardhurave nga *taksat vendore me rreth 69%* te totalit. Rritja e te ardhurave nga taksat eshte parashikuar ne vleren 88,566 mije leke duke shenuar me 16% krahasuar me fillimin e vitit 2025.

Tarifat vendore zene rreth 27% te totalit te buxhetit nga te ardhurat e veta. Ndryshe nga taksat, niveli i tarifave eshte ne kopetencat e bashkise dhe miratuar ne Keshillin e Bashkise, ne varesi te kostove te sherbimit. Të ardhurat nga tarifat jane po aq te rendesishme ne buxhetin vendor sa edhe taksat. Niveli i tarifave eshte i lidhur drejtpersedrejti me kostot e sherbimeve publike qe ofron Bashkia ne te gjithe territorin e saj. Parashikimi i rritjes se te ardhurave nga tarifat per vitin 2026 eshte 20,372 mije lek ne rritje me 8% krahasimisht me fillim vitin 2025.

Te ardhurat e tjera jane gjithashtu nje ze i rendesishem ne strukturen e te ardhurave me 3.7% te parashikimit per vitin 2026. Peshen kryesore ne kete strukture e zene te ardhurat administrative qe perfitohen kundret sherbimeve te ofruara ne bashki,te ardhura nga asetet e dhena me qera etj.

- Taksat Vendore

Të ardhurat nga taksat përfaqësojnë burimin me me peshe ne buxhetin e Bashkise Sarande.Taksimi per bizneset per taksat vendore behet ne zbatim te Ligji nr. 9632, date 30.10.2006 " per sistemin e taksave vendore". Parashikimi e te ardhurave nga taksat ne buxhetin e vitit 2026 eshte **635,602 mije** lek me rritje prej 1**9.5%** krahasimisht me vitin e meparshem.
Baza e taksueshme eshte elementi baze per pellogaritjen dhe parashikimin e te ardhurave nga te gjitha kategorite e taksave. Rritja e bazes se taksueshme nepermjet uljes se informalitetit ben te mundur parashikimin e te ardhurave buxhetore nga taksat ne rritje te konsiderueshme. Ne territorin e Bashkise Sarande operojne mesatarisht 4,500 biznese vjetore dhe sezonale.
Numri i familjareve qe kontriubojne ne buxhetin nepermjet takses se se nderteses eshte rreth 17,750 familje .

a) **Taksa mbi ndertesen.** Taksa mbi ndërtesën është ndër burimet më me peshë në buxhetin e Bashkisë Sarande dhe përbën rreth 26% të te ardhurave nga taksat vendore. Llogaritja e taksës për ndërtesën/njësi pronësore bazohet në vleren e prones, si baze e taksueshme dhe shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, më specifikisht sipas pikes 5, te nenit 2, te VKM 132/2018, te ndryshuar, sipas kategorive të ndërtesave, si më poshtë:

a) 0,05%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim;

b) 0,2%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;

Për këtë qëllim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë, në bashkëpunim me institucione të tjera qëndrore si, OSHEE, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, etj. kanë detyrimin e ngritjes së bazës së të dhënave, krijimin e Kadastrës Fiskale, si informacioni bazë i domosdoshëm për përllogaritjen dhe mbledhjen e të ardhurave nga taksa mbi ndërtesën.

Për Bashkinë e Sarandes, struktura përgjegjëse për llogaritjen dhe mbledhjen e detyrimit për këtë taksë nga subjektet që realizojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë, është Drejtoria e

Taksave dhe Tarifave Vendore, ndërsa për detyrimet e kategorisë familjarë, është përzgjedhur si Agjent tatimor Ujësjellës-Kanalizime Sarande sh.a, me vendim të Këshillit Bashkiak, dhe rregulluar sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr.1169 datë 03.03.2023. Nëpërmjet strukturës së Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Sarande ka aplikuar taksën mbi ndërtesën sipas ndryshimeve ligjore, për kategorinë e ndërtesave që shfrytëzohen për aktivitet ekonomik që prej hyrjes në fuqi të ligjit.


Për sa i përket kategorisë së ndërtesave, për familjet që nuk kanë kryer vetdeklarimin faturimi është kryer në bazë të hapave të parashikuar në Vendimin nr.132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" të ndryshuar. Ky proces është vështirësuar gjatë këtyre viteve nga pamundësia e aksesit në banesat e qytetarëve për kryerjen e matjeve në terren të sipërfaqeve të banueshme.

Realizimi i pritshëm i taksës së ndërtesës pritet te jete ne nivele reth 80-85%, duke marre parasysh nivelin e arketimeve te UK per kategorine familjare.

Parashikimi buxhetor per vitin 2026 per kete kategori takse eshte ne vleren 165,146 mije lek**e** me rritje prej 15% krahasimisht me fillim vitin 2024. Parashikimit ne rritje u be per arsyen e shtimit ne menyre te shpejte te siperfaqes se ndertimeve si biznes dhe familjare. Kjo do te sjelle nje skeme me te zgjeruar te ndertesave, baze e taksueshme per taksen e nderteses.

Më poshtë pasqyrohet në vite realizimi i taksës mbi ndërtesën për kategoritë famijare dhe biznese.

Emertimi	Fakt 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Taksa e nderteses	113,101	142,675	165,146	180,100	196,399



b) Taksa mbi token bujqesore

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, Këshilli Bashkiak mund të miratojë nën kategorizime.

Vlera e taksës në lekë/hektar/vit, miratuar me akte ligjore sipas bashkive dhe kategorisë së tokës, paraqitet në tabelë:


nr	Kategoria e Tokës		Njësia e matjes	2024	2025
1	Kategoria	I	Lekë/ha/vit	5,600	5,600
2	Kategoria	II	Lekë/ha/vit	4,900	4,900
3	Kategoria	III	Lekë/ha/vit	4,200	4,200
4	Kategoria	IV	Lekë/ha/vit	3,600	3,600
5	Kategoria	V	Lekë/ha/vit	3,000	3,000
6	Kategoria	VI	Lekë/ha/vit	2,400	2,400
7	Kategoria	VII - X	Lekë/ha/vit	1,800	1,800

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, Këshilli Bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

Aktualisht, ka të një baze të dhënash mbi tokën bujqësore, planifikimi bazohet mbi keto te dhena dhe ne vijim do te saktesohen pasi punohet per rregjistrimin e tokave bujqesore si pasuri e fermereve, dhe te finalizohet rregjistri i fermereve , baze mbi te cilen parashikohet edhe rritje ne nivelin e te ardhurave nga kjo takse. Ne tabelen e meposhtme pasqyrohet ecuria e parashikimeve buxhetore per kete takse;

në 000/lekë

Taksa e tokes bujqesore	Fakt 2024	Plan 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Familjare dhe biznese	4,466	8,981	6,000	6,000	6,000



c) Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja


Taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja i nënshtrohen të gjitha subjektet që kërkojnë të pajisen me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi për objekte banimi, administrative,

prodhimi, shërbimi e tjera. Struktura e ngarkuar për këtë taksë është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ndërkohë që pranon kërkesat, i shqyrton ato dhe pas miratimit nga Titullari, kryen edhe zbardhjen e kësaj leje kundrejt arkëtimit më parë të vlerës sipas përcaktimeve ligjore. Realizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë paraqitet me tejkalim per arsye se kerkesat per leje tejkalojne parashikimet. Parashikimi ne buxhetin per vitin 2026 eshte bere ne rritje me 16% krahasimisht me planin 2025 duke ndjekur dhe ecurine e zhvillimit ne fushen e ndertimit duke bere qe per nje periudhe afatmesme te ardhurat nga kjo takse te jene te rendesishme ne buxhetin e Bashkise Sarande dhe ndertimi te jete nje nga shtyllat krysore te ekonomise vendore.

Më poshtë shohim ecurine e parashikimeve te të ardhurave nga taksa e ndikimit ne infrastrukture**.**

në 000/lekë

Emertimi	Fakt 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Taksa e ndikimit ne infrsatrukture	179,428	150,800	175,000	180,000	196,063



d) Taksa për fjetjen në hotel

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Llogaritja e kësaj takse, bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe paketes Fiskale te Bashkise Sarande bëhet sipas ndarjes në dy kategori:

- Subjekte hoteleri me 4-5 yje

- Subjekte hotele, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese sipas përcaktimeve të ligjit për taksat vendore.


Ne Sarande aktiviteti i strukturave akomoduese nuk shtrihet gjate gjithe vitit dhe si e tille eshte e domosdoshme prezenca e kontrolleve nga strukturat e Bashkise per te monitoruar njesite akomoduese, per te minimizuar evazionin fiskal dhe taksuar ne menyre te drejte dhe te ndershme bizneset.

Ne Sarande dhe Nj.A gjithashtu numri i njesive akomoduese rezulton te jete ne rritje duke bere qe te rritet edhe baza e taksueshme per kete kategori. Si nje kategori e te ardhurave me premtuese per buxhetin, e lidhur ngushte me rritjen e turizmit ne vendin tone, parashikimi per periudhen afat mesme eshte bere me rritje prej 36%.

Bazuar edhe në të dhënat historike të realizimit të arkëtimeve, parashikimi i të ardhurave nga taksa e fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

në 000/lekë

Emertimi	Fakt 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Taksa e fjetjes ne hotel	78,512	68,000	78,200	85,238	92,772



e) Taksa e tabelës

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve, subjekteve të transportit dhe profesioneve të lira.

Taksa e tabelës përbëhet :

I. Tabelë për qëllime identifikimi të trupëzuara ose jo brenda territori ku zhvillon veprimtarinë e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve (ku shënohet emri dhe ose aktiviteti i biznesit):
   - ✓ Tabelë deri në 2 m2;
   - ✓ Tabelë mbi 2 m2 deri në 10 m2 ;
     - e thjeshtë (pa ndricim)
     - me ndricim të thjeshtë;
     - elektronike.
   - ✓ Tabelë mbi 10 m2 deri në 20 m2 ;
     - e thjeshtë (pa ndricim)
     - me ndricim të thjeshtë;
     - elektronike.

- ✓ Tabelë mbi 20 m2 deri në 40 m2 ;
  - e thjeshtë (pa ndricim)
  - me ndricim të thjeshtë
  - elektronike
- ✓ Tabelë mbi 20 m2 deri në 40 m2 ;
  - e thjeshtë (pa ndricim)
  - me ndricim të thjeshtë
  - elektronike

II. Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelës për orientim.

III. Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme/e palëvizshme deri në tavanin 35 m2:
- ✓ Tabelë e thjeshtë me/pa ndricim;
- ✓ Tabelë elektronike.


IV. Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj. (të të gjitha përmasave)

Ecuria e te ardhurave te taksës së tabelës ndër vite është përgjithësisht e qëndrueshme edhe pse në varësi të zgjedhjes së biznesit për të reklamuar ose jo në një vit të caktuar, ndërkohë që për tabelën për qëllime identifikimi, deri në 2 m2, masa e taksës është zero.

Parashikimi në vite pasqyrohet në tabelën më poshtë:

në 000/lekë

Emertimi	Fakt 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Takse tabele	1,743	1,600	2,500	2,500	2,500
Takse reklame	4,918	5,700	4,800	5,592	6,530




- Të ardhurat nga taksat e ndara.

f) Taksa e kalimit të të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Mbledhja e kësaj takse realizohet nga strukturat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, agjent tatimor që përfiton edhe 3% të shumës së arkëtuar. Të dhënat për parashikimin e kësaj takse merren nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës e cila finalizon dhe evidenton të gjitha rastet e transkriptimit të pronës duke llogaritur detyrimin si për llojin e pronësisë por dhe vlerën e detyrimit mbi bazën e sipërfaqes së taksueshme. Kështu detyrimi për banesat është në nivelin 300 lekë/m2 dhe për objektet e biznesit është 700 lekë/m2 . Numri i objekteve që transkriptohen është i lidhur ngushtë me lejet e shfrytëzimit të lëshuara nga njësitë vendore për objektet e përfunduara por dhe nga ALUIZNI. Parashikimi i buxhetit per periudhen ne analize pasqyrohet ne tabelen e meposhtme:

në 000/lekë

Emertimi	Fakt 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Taksa e kalimit te se drejtes se pronesise	6,919	16,500	14,500	14,500	14,500




g) Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura

E ardhura nga taksa, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (Drejtoria Rajonale Sarande), para kryerjes së kontrollit teknik të detyrueshëm të mjetit, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore por e konvertuar në përqindje, në masën 25 % e të ardhurave të realizuara për çdo muaj nga agjentët tatimor të DPSHTRR.

Ne buxhetin e bashkise kjo takse ze rreth 4% te buxhetit. Ne tabelen e meposhtme shohim parashikimin per periudhen afatmesme dhe per vitin 2026.

në 000/lekë

Emertimi	Fakt 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Taksa e mjeteve te perdorura	30,383	26,500	30,500	33,245	36,100




J) Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale që u takon Njësive të qeverisjes vendore përfaqësojnë vlerën 2% e totalit të të ardhurave nga Tatimi mbi të ardhurat personale që arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Perllogaritja e parashikimeve buxhetore behet duke marrë si bazë llogaritje përqindjen e numrit të banorëve për Bashkinë e Sarandes kundrejt numrit total të banorëve në vend. Në parashikimet nga kjo taksë, ndryshimi në krahasim me parashikimet e mëparshme i atribuohet edhe mënyrës së shpërndarjes ndërmjet bashkive i të ardhurave të përgjithshme të njësive vendore nga TAP. Bashkia e Sarandes, për vitet 2026–2028, nisur nga llogaritjet e përafërta mbi përkatësinë e pjesës takuese nga totali i parashikuar nga DPT, ka parashikuar të njëjtin nivel të ardhurash, si më poshtë:

në 000/lekë

Emertimi	Fakt 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Tatim mbi te ardhurat personale	12,892	8,000	10,524	10,524	10,524



- **Tarifat Vendore**

Të ardhurat **nga tarifat** jane te rendesishme në strukturen e te ardhurave, duke kontriubuar **me 27.4%** ne buxhetin e te ardhurave te veta te Bashkise.

f) Tarifa e sherbimeve (pastrimit, gjelberimit, ndicim).

Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, qe banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Sarandes. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave mblidhet nga dy struktura, përkatësisht nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për kategorinë e biznesit, dhe Ujësjellës – Kanalizime Sarande Sha për kategorinë familjarë. Që prej vitit 2012 e në vijim tarifa e pastrimit mblidhet nga agjenti tatimor UK sha, periudhë e cila shënon një rritje të ndjeshme të të ardhurave nga kjo tarifë, megjithëse jo në nivelin e kapacitetit te mundshem. Rritja afatmesme e tarifave eshte parashikuar rreth 18% ne vit e ardhur kjo vetem nga rritja e bazes se tarifimit. Per vitin 2026 ne strukturen e tarifave eshte parashikuar me 85 % nga tarifa e sherbimeve publike.

Parashikimi i të ardhurave nga subjektet e biznesit është mbështetur në kapacitetin e taksapaguesve që përfaqësojnë numrin e subjekteve aktive të evidentuara dhe nivelin e tarifës për vitin ushtrimor, bazuar në nivelin e xhiros vjetore qe ato raportojne ne DTTV. Për kategorinë familjarë parashikimi është bazuar në numrin e familjeve raportuar nga Agjenti tatimor dhe niveli i tarifes ne paketen fiskale eshte i diferencuar per familjet ne Sarande, dhe Ksamil me 38% krahasimisht me zonat rurale.


E strukturuar sipas kategorise se sherbimeve ; -79% e ze tarifa e pastrimit , -12% e ze tarifa e ndricimit dhe -6% e zetarifa e gjelberimit.

Parashikimi i buxhetit per burimet nga tarifa e sherbimeve publike eshte rritur me 9 % krahasimisht me vitin paraardhes. Rritja bazohet kryesisht ne zgjerimin e bazes se taksueshme, duke mbajtur parasysh rritjen e bizneseve ne numer, si edhe numrin te familjeve rezidente dhe jorezinente.

Ne tabelen e meposhtme pasqyrohet buxheti me te ardhurat nga tarifat e sherbimeve publike.

Ne 000/lek

Emertimi	Fakt 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Te ardhura nga tarifat e sherbimeve	146,768	200,895	216,967	227,815	239,206



g) Tarifa për zënien e hapësirave publike


Tarifa për zënien e hapësirave publike llogaritet për sipërfaqen në m² të shfrytëzuar nga subjekti për ushtrimin e aktivitetit të indeksuar sipas zonës së vendndodhjes dhe nivelit të taksës për njësi të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Tarifa për zënien e hapësirave publike përbëhet nga:

- Zënia e hapësirës publike per perdorim vjetor .
- Zenie hapesire publike per perdorim sezonal.
- Zënia e hapësirës publike në plazhet publike .
- Zënia e hapësirës publike per tregje publike.

Nga te dhenat historike per arkëtimet nga tarifa e zënies së hapësirës publike shikojme rritje në mënyrë të qëndrueshme, si pasoje e uljes se informalitetit dhe rritjes se kerkeses per hapesira publike te marra me qera. Për vitin 2025 realizimi pritet te jetë me tejkalim buxheti si rezultat i kerkesave per hapesirave pertej parashikimit fillestar. Duke marre parasysh edhe ecurine e realizmit progresiv te kesaj tarife eshte bere edhe parashikimi buxhetor ne rritje me 7% per vitin 2026. Baza e tarifimit jane siperfaqet qe bashkia ka ne dispozicion per ushtrim aktiviteti bizneseve. Paraqitja tabelore dhe grafike e te ardhurave nga tarifa e zenies se hapesires publike eshte si me poshte;

Ne 000/lek

Emertimi	Fakt 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Te ardhura nga zenia e hapesires publike	115,871	115,680	123,932	135,230	147,264



h) Tarifa e parkimit

Tarifa për parkimin e automjeteve në vend parkime publike përfaqëson tarifen e shërbimit per parkime te rezervuara ne rruge dhe sheshe per te gjitha llojet e mjeteve. Per vend parkimet e rezervuara buxheti i parashikuar ne buxhet eshte ne rritje me 80% krahasimisht me vitin e meparshem duke marre parasysh pritshmerine e realizimit te buxhetit per vitin aktual.


Persa ju perket te ardhurave nga parkimet publike, te parashikuara per tu tarifuar sipas paketes fiskale, per arsye te problematikave te hasura ne terren dhe numri i limituar i parkimeve ne qytetin

e Sarandes, eshte e pa implementuar metoda e dhenies se rrugeve te cilesuara si te mundshme per parkime me pagese/ore.

Parashikimi afat mesem i te ardhurave nga kjo tarife, bazuar edhe ne te dhenat historike, paraqitet si me poshte;

e 000/lek

Emertimi	Fakt 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Te ardhura nga tarifat parkimit	7,873	6,680	12,000	12,000	12,000




i) Të ardhura nga pagesat për kopshte, çerdhe e konvikte.

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa mujore, e cila përbëhet nga tarifa për ushqimin që llogaritet me tarifën ditore dhe ditët e frekuentimit të fëmijës gjatë një muaji si me poshte;

ne 000/lek

Emertimi	Fakt 2024	Plan 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Te ardhura nga kopshte, cerdhe, konvikte	9,007	8,000	9,000	9,000	9,500




A.3) Te ardhura te tjera

Në të ardhurat e tjera përfshihen kryesisht të ardhura destinacioni i të cilave nuk identifikohet që në momentin e arkëtimit dhe shpërndahen në destinacionet përkatëse sipas rakordimeve që realizohen nga Drejtotia e Tarifave dhe taksave vendore. Gjithashtu këtu përfshihen edhe të ardhurat nga qeratë e ndërtesave dhe trojeve ne pronesi te bashkise, të ardhura nga penalitete administrative apo gjoba të vendosura nga Policia Bashkiake, etj. Parashikimi per periudhen afatmesme pasqyrohet ne tabelen e meposhtme;

ne 000/lek

Emertimi	Fakt 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Te ardhura te tjera	17,784	26,700	25,900	24,900	23,900



Ne buxhetin 2026 te ardhurat nga dhenia me qera e aseteve eshte parashikuar ne shumen 6,300 mije leke, duke ju referuar te dhenave baze per asetet ne administrim te Bashkise Sarande, si edhe te dhenave historike te realizimit te kesaj tarife. Pasurite qe jepen me qera, bazuar ne VKM nr 529/2014 " Per percaktimin e kritereve, te procedures dhe menyres se dhenies me qera, enfiteoze apo kontratat e tjera te pasurise shteterore" i ndryshuar jane mjediset ne administrim te bashkise,.
Te ardhurat nga shitja e trojeve**,** perllogaritet ne zbatim te VKM ne 329/2019 per shitjen e trojeve nga Bashkite eshte parashikuar ne buxhet shuma prej 3,000 mije lek ne nivel relativisht te ulet duke ju referuar edhe natyres ciklike te kesaj tarife.


A.2) Te ardhura nga transfertat

a) Transferta e Pakushtëzuar

Transferta e pakushtëzuar që buxheti qendror i transferon pushtetit vendor, përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme shpërndahet ndërmjet njësive të pushtetit vendor sipas formulës së paraqitur në ligjin nr. 68 datë 27.04 2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" , ligjit vjetor të buxhetit si dhe udhëzimeve plotësues. Ecuria e transfertës së pakushtëzuar për Bashkinë e Sarandes pasqyrohet si me poshte;

ne 000/lek;

Emertimi	Fakt 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Transferta e pakushtezuar	274,150	301,873	331,100	347,946	366,058
Ndryshimi ne %	109%	110%	110%	105%	105%




b) Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Funksionet e reja që iu transferuan bashkive në vitin 2016, me Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" si Transferta Specifike jane parashikuar per financim edhe në buxhetin e vitit 2026 nëpërmjet Transfertës së pakushtëzuar sektoriale. Më konkretisht:

- ✓ Konviktet e arsimit parauniversitar
- ✓ Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)
- ✓ Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar
- ✓ Administrimi i pyjeve
- ✓ Ujitja dhe kullimi

Te ardhurat nga transferta e pa kushtezuar sektoriale, jane ne forme transferte nga buxheti i shtetit per te financuar funksionet e deleguara(kryesisht me shpenzimet per paga) te njesive te varesise per 115 punonjes. Nepermjet kesaj transferte financohen shpenzimet per paga dhe sigurimet shoqerore per sektorin e arsimit, dhe nje pjese te shpenzimeve operative te sektoreve te tjere, pjese te kasaj transferte parashikuar ne shumen 161,148 mije lek, per vitin 2026 me nje rritje prej 10%.
Nderkohe qe kopetencat per menaxhim dhe detyrime shtese per te siguruar funksionimin normal te ketytre sektoreve i buxhetohen nga fondet e veta te bashkise.
Ecuria e transfertës së pakushtëzuar sektoriale për Bashkinë e Sarandes pasqyrohet si me poshte, ne 000/lek;

Emertimi	Fakt 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Transferta e pakushtezuar sektoriale	122,843	146,084	161,148	161,148	161,148
Ndryshimi ne %	100%	119%	100%	100%	100%



- ✓ *Konviktet e arsimit parauniversitar*, ne mbeshtetje te arsimit te mesem profesional , per vitin 2026 pjese e transfertes se pakushtezuar sektoriale eshte planifikuar per shpenzimet per pagat, sigurimet shoqerore, shpenzimet operative dhe investime ne vleren **20,897 mije leke** ne rritje me 3% ne raport me nje vit me pare. Standartet dhe kriteret e sherbimit do te kryhen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi.
- ✓ *Sherbimi per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi (PMNZSH).* Ne transferten e planifikuar per vitin 2026, jane fondet per PMNZSH. Ne kete fond bejne pjese fondi i pagave, sigurimeve shoqerore si dhe fondi per shpenzimet operative. Standartet e ofrimit te sherbimeve do te behen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi. Shuma e planifikuar per kete funksion eshte **28,670 mije lek**. Nga buxheti i bashkise me te ardhurat e veta mbulohen edhe nevoja shtese te domosdoshme per kete sektor.
- ✓ *Personeli mesimor dhe personeli mbeshtetes ne arsimin parashkollor dhe personeli mbeshtetes ne arsimin parauniversitar*. Ne transferten sektoriale te vitit 2026, jane parashikuar fondet per personelin arsimor dhe ate ndihmes per arsimin parashkollor si dhe per personelin ndihmes per arsimin parauniversitar me perjashtim te arsimit te mesem profesional. Parashikimi i fondeve per kete vit jane ne shumen **94,463 mije leke** ne rritje me 11% krahasimisht me nje vit me pare. Fondet e alokuara per kete program jane te destinuara per pagat dhe sigurimet shoqerore.
- ✓ *Administrimi i pyjeve*

  Ne transferten e pakushtezuar sektoriale te vitit 2026, jane fondet per Sherbimin pyjor. Ne kete fond bejne pjese fondi i pagave, sig. shoqerore si dhe fondi per shpenzimet operative. Standartet e ofrimit te sherbimeve do te behen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi. Shuma e planifikuar per kete funksion eshte **3,782 mije lek** ne rritje me 18% krahasimisht me nje vit me pare.
- ✓ *Ujitja dhe Kullimi*

  Ne transferten e pakushtezuar sektoriale te vitit 2026, perfshihen edhe fondet per Ujitjen dhe Kullimin. Ne kete fond bejne pjese fondi i pagave, sig. shoqerore si dhe fondi per shpenzimet operative. Standartet e ofrimit te sherbimeve do te behen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi. Shuma e planifikuar per kete funksion eshte **7,858 mije lek** ne rritje me 7%.

- **Transfertat e Kushtëzuara**

Fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara, nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të njësive vendore, por reflektohen në dokumentin e realizimit të buxhetit, si fonde të administruara nga njësitë vendore. Sipas akteve ligjore në fuqi, funksione të deleguara në pushtetin vendor janë si më poshtë:

Shërbimi i gjendjes civile si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative bëhen nga bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve më të detajuara që bëhen nga Ministria e Brendshme. Numri i punonjësve dhe kuotat përkatëse për këtë funksion përcaktohen nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Përkrahja sociale, si funksion i deleguar i detyrueshëm, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale detajon në fillim të vitit fondet për përkrahjen sociale për çdo njësi të qeverisjes vendore, në mënyrë specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftesise.

Te ardhurat nga buxheti i shtetit alokohen ne formen e **transfertes se pakushtëzuar, dhe granteve per investime.** Transfertat buxhetore per investime perbejne një burim financiar thelbësor në përmbushje të funksioneve ekskluzive të bashkise, nepermjet realizimit te projekteve per investime publike.

A.3) Fondet e mbartura (te paperdorura)

Te ardhura te paperdorura kane nje kontriubut te konsiderueshem ne buxhetin vjetor te viteve te fundit, dhe per vitin 2026 parashikohen te zene 24% te buxhetit total. Fondet e mbartura perbehen nga (i) tejkalimi i realizimit te parashikimit te te ardhurave dhe (ii) mosrealizimi i shpenzimeve buxhetore ne masen njeqind per qind.

Fondet e mbartura përfaqësojnë ato fonde (likuiditete), të cilat janë gjëndje në fund të vitit buxhetor dhe nuk arrijnë të shpenzohen brenda vitit për arsye te ndryshme si psh: tejkalimi të realizimit të të ardhurave, mos realizimi të shpenzimeve të planifikuara, të tjera të cilat afektojnë dinamikën e vitit. Fondi i planifikuar për t'u mbartur për vitit 2026 nga Bashkia Sarande parashikohet te jete 450,000 mije lekë. Arsyet që afektojnë mbartjen janë si më poshtë:

1. **Realizimi i të ardhurave**: për vitin 2025, të ardhurat e Bashkisë së Sarandes janë me tejkalim kundrejt planit të miratuar. Deri në mesin e muajit Nëntor të ardhurat janë tejkaluar në vlerën me 10% ne raport me planin per periudhen, e ndikuar nga disa faktore si psh, arketimi i debitoreve nga vitet e kaluara apo edhe te ardhura jashte limitit sikunder eshte te ardhurat nga gjobat e policise bashkiake etj..

2. **Realizimi i shpenzimeve**: për periudhen Janar - Tetor 2025 treguesit e realizmit të buxhetit janë në vlerën 83% nga të ardhurat dhe transferta e pakushtezuar dhe ajo sektoriale. Referuar një prognoze të kryer për muajt nëntor -dhjetor 2025 duke marë në konsideratë dhe % e realizimit të dy mujorit të fundit të vitit të kaluar, pritet një realizim i buxhetit deri në 86-88% të planeve të miratuara.

B. SHPENZIMET BUXHETORE

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Sarandes për periudhën 2026-2028, për të gjitha funksionet parashikohen respektivisht në masën 1,865,717 mije lekë; 1,845,737 mije lekë; dhe 1,928,425 mije lekë. Në parashikimin e viteve buxhetorë është përfshirë edhe një pjesë e konsiderueshme e fondit që do të mbartet nga viti paraardhës. Fondet e mbartura në këtë fazë përfshijnë fondet e papërdorura në vitin respektiv nga të ardhurat.
Totali i parashikimit te kerkesave buxhetore te Bashkise Sarande per funksionimin e pushtetit vendor, paraqet nje situate të përgjithshme mbi mënyrën se si do te shpenzohen fondet në dispozicion:

- ✓ *sipas burimit të financimit,*
- ✓ *sipas kategorizimit te natyrës ekonomike* (paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime) dhe
- ✓ *sipas funksioneve të programeve te qeverisjes lokale* (arsim, sherbime publike, kulture, etj.).

Ne buxhetin e vitit 2026, Bashkia Sarande kanalizon;

- 31**%** të totalit burimeve financiare për mbulimin e shpenzimeve per pagat dhe sig. shoqerore**,**
- 31% te buxhetit parashikohen per shpenzimet korrente,
- 38 **%** jane parashikuar për shpenzime kapitale.


Shpenzimet sipas burimit te financimit

Ne pasqyren e shpenzimeve paraqet një panoramë e përgjithshme mbi mënyrën si janë shpendare fondet në dispozicion sipas programeve per vitin 2026: sipas burimit të financimit dhe kryqëzuar me kategorizimin sipas natyrës ekonomike (paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime) dhe sipas funksioneve të qeverisjes (arsim, çështje ekonomike e kulturore, mbrojtje mjedisi, sherbime publike etj.).

- *Shpenzime nga te ardhurat e veta vendore (perfshire te ardhurat e paperdorura)*, jane parashikuar 1,220,900 mije leke me perberje te struktures si me poshte;
  - 28% shkojne per pagat dhe sigurimet shoqerore te punonjesve,
  - 32% jane parashikuar per shpenzimet korrente,
  - 35% eshte parashikuar per shpenzime per investime publike ne infrastrukture dhe sherbime.
  - 5% e te ardhurave jane parashikuar per transferta te brendshme.

- *Shpenzime nga transferta e pakushtezuar dhe transferta sektoriale (perfshire edhe fondet e paperdorura)* jane parashikuar ne shumen 644,818 mije lek nga te cilat;

- 28% per pagat dhe sigurimet shoqerore te punonesve,
- 26% per shpenzimet korrente dhe
- 46% per investime kapitale



- Ndarja e fondeve buxhetore sipas natyres ekonomike;

1) Shpenzimet per pagat dhe sigurimet shoqerore,

Perbejne rreth 30% te buxhetit ne vleren 561,966 mije leke per vitin 2026; 561,966 mije lek per vitin 2027 dhe 567,585 mije lek per vitin 2028, per 460 punonjes civile dhe punonjes mbeshtetes, ne Aparatin e Bashkise dhe njesite e varesive. Ndër politikat e ndjekura për vitet e fundit një reformë e rëndësishme është rritja e nivelit të pagave për punonjësit, mbeshtetur ne nismat ligjore te qeverise per rritjen e pages minimale dhe mesatare ne shkalle vendi. Bazuar në shtimin e fuksioneve dhe kapaciteteve të punës, jane parashikuar efektet e rritjes se pritshme te pages minimale dhe pagave ne teresi me rreth 10% te buxhetit per pagat dhe sig. shoqerore

2) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative dhe të tjera janë parashikuar në shumën 559,983 mije lekë për vitin 2026, 573,000 lekë për vitin 2027 dhe 583,759 lekë për vitin 2028. Këto shpenzime përbëjnë 30% të totalit të buxhetit për vitin 2026 dhe përbëhen nga:

- Shpenzimet operative të aparatit të Bashkisë dhe institucioneve në varësi;
- Përdorimi i Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës;
- Transferta të tjera për individët

Fondi i Kontigjencës do të përdoret për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve egzistuese, në rast se do të jetë e nevojshme, gjithmonë me miratimin e Këshillit Bashkiak.

Transfertat për individët përbëhen nga transfertat në mbështetje sociale të shtresave në nevojë si bonusi i strehimit, dëmshpërblime në raste fatkeqësish natyrore, stimuj ekselence, si ai për nxënësit e shkëlqyer dhe stimuj të tjerë.

Në thelb të planifikimit të shpenzimeve operative është racionalizimi i shpenzimeve administrative, duke vënë theksin në rritjen e financimit për shërbimet publike me qëllimin e për përmbushjen e funksioneve kryesore të Bashkisë së Sarandes ne sherbim te komunitetit. Peshën më të madhe në shpenzimet operative e mbajnë funksionet prioritare: shërbimet publike vendore, arsimi parashkollor dhe parauniversitar, art, kulture, dhe te tjera sherbime thelbesore.


3) Shpenzime kapitale , jane parashikuar në shumën **730,869 mije lekë** dhe zë 39 % ndaj totalit të shpenzimeve. Për vitet 2027 dhe 2028, buxheti i investimeve eshte parashikuar respektivisht 726,295 mije lekë dhe 797,788 mije lekë.

Për vitin 2026 peshën më të madhe e zënë shpenzimet kapitale për programet e Rruge dhe rrjete, Arsimit parashkollor dhe parauniversitar, Sherbimet publike, Ujesjelles dhe kanalizime, Art dhe Kulture, Studime dhe projektime.

Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.(600.601.602.231)

Artikulli	Emertimi	Fakti	Buxheti Vjetor 000/ lek				
		i vitit paraardhes Viti 2024	Plan Fillestar Viti _2025	Plan i Rishikuar Viti_2025	Plani V 2026	Plani V 2027	Plani V 2028
600	Paga	287,280	445,269	445,269	492,897	505,864	511,709
601	Sigurime Shoqërore	49,116	72,426	72,426	81,968	93,848	94,000
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	377,465	476,183	493,183	503,900	519,097	529,856
604	Transferta Korente të Brendshme	7,763	38,333	38,333	37,500	32,000	32,000
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		11,200	11,200	13,583	16,903	16,903
609	Fond rezerve/ kontigjence	-	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	721,624	1,048,411	1,065,411	1,134,848	1,172,711	1,189,467
230	Kapitale të Patrupëzuara				10,000		
231	Kapitale të Trupëzuara	225,677	604,677	990,731	720,869	702,505	773,762
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	225,677	604,677	990,731	730,869	702,505	773,762
Totali (korrente + kapitale)		947,301	1,653,088	2,056,142	1,865,717	1,875,216	1,963,229

Grafikisht , shpenzimet buxhetore sipas kategorive ekonomike



Shpenzimet sipas programeve buxhetore

Buxheti ne dispozicion nga burimet e te ardhurave do te jene ne dispozicion per financimin e te gjitha programeve, pjese perberese e funksionimit te pushtetit vendor. Bashkia e Sarandes ka ne perberjen e saj 13 programe te specifikuara me funksione te ndara, te harmonizuara ne menyre te tille qe te sigurojne realizimin e objektivave te pushteti vendor. Perberja e programeve paraqitet si me poshte;

i. Menaxhim, Administrim, Planifikim (Aparati i Bashkise)

Buxhetimi per kete program perfshin shpenzimet per pagat dhe sigurimet shoqerore, shpenzimet korrente , shpenzimet per investimet publike si edhe transferta ne te trete apo ne individe ne shumen **539,150** mije lek duke zene **29%** te totalit te buxhetit;


- ✓ ***Shpenzimet per pagat dhe sigurimet shoqerore****,* llogaritjen e fondit te pagave dhe sigurimeve shoqerore per administraten e Bashkise dhe punonjesit e njesise administrative, ne tolal **143 punonjes** ne buxhet per vitin 2026 jane parashikuar **248,462 mije lek,** ne rritje me 9% nga nje vit me pare, per efekt te rritjes te shtimit ne strukturen e Aparatit, Policise Bashkiake 5 punonjes policie si edhe ngritjes se nje strukture shtese per Menaxhmin e Aseteve te Bashkise.
- ✓ ***Shpenzimet korrentete te*** *parashikuara ne shumen* **237,428 mije lek** ne rritje me 13% ne raport me vitin 2025 perfshijne;
  - *Shpenzimet operative* te parashikuara ne vleren 103,910 mije lek. Ne kete ze shpenzimesh jane parashikuar;
    - *Materiale zyre*, kancelari, material pastrimi, materiale per paisjet e zyrave, materiale promocionale, publikime, reklamime, promovime, uniforma per punonjesit e bashkise eshte parashikuar ne shumen *9,900 mije leke*.
    - *Sherbime me te trete e parashikuar* ne shumen *48,620 mije lek*, perfshin shpenzimet per energjine per ndricimin publik per te gjithe territorin Bashkise, dhe njesine administrative, per qendrat sociale etj. Ne kete ze shpenzimesh futet edhe sherbimi i printimit per aparatin e bashkise dhe Nj.a, sherbimin telefonik, komunikim me mediat, si edhe mirembajtjen e sistemit elektonik ne te gjithe administaten perfshire edhe sistemin e kamerave te qytetit.
    - *Shpenzime per sherbime publike* eshte parashikuar ne shumen *38,400 mije* leke, ku perfshihen; Menaxhimin e aseteve publike, mirembajtje te mjediseve ne administrim te Bashkise, trajtim te kafsheve te rrugeve, mjete per sigurimin e ruajtjes te jeteve ne det ne plazhet publike gjate sezonit turistik, mirembajtje dhe rinovim te paisjeve te PMNZSH-si edhe detyrime te paparashikuara administrative lidhur me natyren e sherbimeve qe ofron pushteti vendor.
    - *Shpenzime transporti* jane parashikuar ne shumen 6,900 mije lek. Ne kete ze shpenzimesh perfshihen shpenzimet per karbunant per mjetet e transportit ne pronesi te bashkise ne funksion aparatit te bashkise, bordit te kullimit, te njesise se zjarrfikeseve shpenzimet per mirembajtjen e tyre, shpenzimet per marrje me qera te mjeteve te natyrave specifike ne dispozicion te qytetareve ne raste festash kombetare dhe lokale, si edhe shpenzimet per

dokumentacionin ligjor te mjeteve. Ne kete shume jane parashikuar edhe shpenzimet per udhetim dhe dieta te punonjesve qe autorizohen per sherbime pune jashte qytetit.

- *Shpenzime per mirembajtje t*e zakonshme jane parashikuar ne shumen 5,100 mije lek te Ne kete ze buxhetor eshte perfshire edhe mirembajtja e tokes bujqesore, si detyrim ligjor per menyren e shpenzimeve te 40% te takses bujqesore etj..
- Shpenzime per qeramarrje jane parashikuar ne shumen 2,250 mije lek dhe buxheton ndertesat dhe ambientet e marra me qera nga Bashkia per funksionet e te tjera.
- *Shpenzime per pritje, percjellje* dhe kuota pjesemarrje jane parashikuar ne shumen 3,500 mije leke dhe parashikohen per te mbuluar shpenzimet per pritje percjellje zyrtare si edhe kuota pjesemarrese ne shoqaten e bashkive.

- Shpenzime per keshilltaret dhe kryepleqte e parashikuar, ne shumen 13,700 mije lek. Ne kete shume perfshihen pagesat per pagat e keshilltareve dhe kryepleqve, te percaktuara ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi, shpenzimet e udhetimit, si edhe shpenzimet per kancelari dhe material te nevojshme ne punen e tyre.
- Shpenzime per promocion turizmi dhe projekte eshte parashikuar ne shumen 29,750 mije lek. Aktiviteti promocional i Sarandes perfshire edhe aktivitetet kulturore dhe argetuese gjate sezonit turistik eshte nje faktor shume i rendesishem dhe luan nje rol te konsiderueshem ne turizmin detar, turizmin kulturor etj. Per vete rendesine qe ka turizmi ne ekonomine vendore, i eshte kushtuar vemendje, nepermjet financimit te eventeve kulturore dhe artistike. Fondet e parashikuara, do te mbeshtesin projektet artistike sipas prioritetit, te percaktuara sipas kuadrit ligjor ne fuqi. Ne politikat afatmesme dhe afat gjata te Bashkise, Industria e Turizmit parashikohet te jete shtylla kryesore, dhe qendrushme e ekonomise vendore. Me shfrytezimin e resurseve Saranda dhe Ksamili jane kthyer nder destinacionet me te frekuentuara ne vend. Synimi i politikave zhvillimore te pushtetit qendror dhe lokal eshte nxitja e nje zhvillimi te qendrushem, te ekuilibruar ekonomik nepermjet politikave te bashkepunimit dhe nxitjes se sipermarrjes private ne sktorin e turizmit dhe jo vetem.
- Shpenzime per agjentin tatimor eshte parashikuar ne shumen 5,500 mije lek. Ne kete fond eshte perllogritur detyrimi kontraktual me agjentet tatimor per mbledhjen e taksave dhe tarifave.
- Shpenzime per bonus strehimi eshte parashikuar ne shumen 5,000 mije lek. Fondi i parashikuar ne buxhet do te perdoret per kompesimin e qerase per shtresat ne nevoje duke zene rreth 50% te buxhetit total me kete destinacion, perfshire edhe financimin e buxhetit qendror.
- Fondi i rasteve emergjente dhe shpronesime per efekt te projekteve ne infrastrukture e te tjera emergjenca eshte parashikuar ne shumen 18,568 mije lek, dhe perben 4% te buxhetit nga te ardhurat e bashkise, ne zbatim te Ligjit 45/2019 “Per mbrojtjen Civile”.
- Shpenzime per detyrimet e prapambetura 800 mije lek. Parashikimi ne ulje i fondit per kete lloj shpenzimi ka te beje me likujdimin e detyrimeve te prapambetura, duke ju permbajtur edhe parashikimit buxhetor afat mesem 2025-2027.
- Shpenzime per vendime gjyqesore jane parashikuar ne shumen 12,000 mije lek. Perllogaritja e ketij fondi ne buxhet eshte bere ne baze te vendimeve gjyqesore, dhe kthime pagesash per leje punimesh te anulluara, te mbartura nga periudha me te hershme.

- Shpenzime per Aktivitetet Sportive eshte parashikuar ne vleren 20,000 mije lek. Ky fond parashikohet per mbeshtetje financiare te Klubit Sportiv "Butrinti",, i cili funksionon ne trajten e nje OJF -je ne zbatim kuadrit ligjor ne fuqi.
- *Transferta korrente te brendshme* e parashikuan ne shumen 7,000 mije lek ne buxhet, perfshin;
    - *Financime (parapagime te kthyeshme) per projektet me financim te BE ne shumen 11,000 mije lek.*
    - *Financime te Qarkut ne shumen 1,000 mije leke , ne trajte kuote per qarkun Vlore.*
- *Transfertat ne individe dhe familje* jane parashikuar ne shumen 10,500 mije lek. Ne kete shume buxhetohen te gjitha familjet ne nevoje ekonomike te cilat nuk klasifikohen nga buxheti i shtetit, si edhe rastet emergjente te identifikuara nga strukturat sociale te Bashkise.
- *Transferta korrente te brendshme* jane parashikuar ne shumen 5,000 mije lek, e perbere prej;
    - *Fondi Rezerve ne shumen 2,000 mije leke*
    - *Fondi i kontigjences ne shumen 3,000 mije leke*
- *Shpenzime per investime kapitale ne te gjitha programetjane parashikuar ne shumen* 730,869 mije lek i financuar teresisht me te ardhurat e Bashkise, ne rritje me 21% ne raport me nje vit me pare.
- *Grafikisht shpenzimet e programit Administrim, Menaxhim Planifikim*;



ii. Programi "Sherbimet publike"

Buxhetimi i programit te sherbimeve publike behet per investime publike dhe Ndermarrjen se Sherbimeve Publike, e cila funksionon per mirmbajtjen e infrastruktures dhe te tjera mirembajtje te mjediseve publike. Ne kete program perfshihen sherbimet e ndicimit, gjelberimit, dekorimin dhe mirembajtjes e infrastruktures publike me nje fond te parshikuar me 168,380 mije lek, ku 57% te buxhetit e zene shpeznimet per personelin dhe 32,8% e zene shpenzimet per sherbimet publike, dhe 12% te totalit e zene investimet publike.

- **Ndermarrja e Sherbimeve Publike**;

Objektivi i Ndermarrjes se sherbimeve publike lidhet ngushte me funksionet e mirembajtjes se hapesirave publike, rehabilitimin e infrastuktures, mirembajtjen e rrjetit te ndricimit publik, mirembajtjen e gjelberimit, varrezave dhe hapesirave dhe lulishteve, mirembajtjen e plazheve publike dhe sigurine e jeteve ne det, etj. E perbere prej 113 punonjes , ndermarrja kryen disa funksione organike qe ka ne pergjegjesine e saj. Fondi i pagave eshte planifikuar ne shumen 112,800 mije lek ne rritje me rreth 12%, dhe ze rreth 59%
te buxhetit vjetor te ndermarjes.

Mirembajtje ne rrjetin elektrik eshte zeri kryesor ne programin e sherbimeve publike e administruar nga Ndermarja e Sherbimeve. Duke marre parasysh financimin per rehabilitimin e linjave te ndricimit vitet e fundit, nevojat qe ka rrjeti i ndricimit publik jane me te uleta per kete vit dhe, fondi ne dispozicion eshte parashikuar ne shumen 8,000 mije lek.

Mirembajtja e infrastruktures publike, eshte nje tjeter ze i rendesishemm ne programin e sherbimeve, mirembajtje trotuaresh, kangjella dhe ambiente te perbashketa publike, e cila konsiston ne zevendesimin dhe riparimin e pjesor ne rast demtimesh dhe jane parashikuar ne shumen 7,000 mije lek ne buxhetin e vitit 2026.


Mirembajtje te siperfaqeve te gjelberuara, eshte pjese e buxhetirt te Ndermarrjes se Sherbimeve. Shpenzime per gjelberimin eshte i planifikuar 3,200 mije lek ne buxhet. Ne kete ze shpenzimesh perfshihen mirembajtja rreth 40,000 m² sip te gjelberuara Sarande dhe Ksamil (29,500 m²/6500m²). Gjithashtu ketu jane perllogaritur edhe biopreparatet qe sherbejne per luftimin e semundjeve te pemeve dekorative te qytetit, zevendesimin e pemeve te demtuara, mirembajtjen e tyre si dhe shpenzimet materiale dhe te tjera ne sherbim te mirembajtjes se varrezave publike te Sarandes dhe Njesise Administrative

Mirembajtje, te dekorit te qytetit, per ditet festive pergjate vitit, eshte pjese e programit te sherbimeve publike. Shpenzime per dekorin i planifikuar 3,000 mije lek ne buxhetin e vitit 2026.

iii. Programi i Pastrimi & Perpunim te mbetjeve urbane .

Perllogaritja e fondit per pastrimin dhe largimin e mbetjeve, eshte bere ne zbatim te ligjit 10463 date 22.09.2011 " Per menaxhimin e Integruar te mbetjeve" dhe VKM nr.319 date, 31.05.2018 "Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve. Preventivi per llogaritjen e fondit limit, referohet ne kriteret dhe standartet e vendosura nga ligjet dhe udhezimet ne fuqi, bazuar ne analizen e kostos per seicilin nga zerat e sherbimeve, volumin e punes dhe siperfaqen e rrugeve te investuar rishtazi. Nisur nga keto referenca dhe qellimi per standartizimin e sherbimit te pastrimit dhe higjenizimit te hapesirave publike te bashkise , nevoja per fondeve ne dispozicion eshte ne rritje. Per vitin 2026 fondi eshte parashikuar ne vleren 158,026 mije lek e njejte me vitin aktual. Shpenzimet per perpunimin e mbetjeve ne Landfillin e Bajkaj jane planifikuar 43,000 mije vlere e njejte me vitin aktual buxhetor. Rritja eshte parashikuar si efekt i shtimit te sasise se mbetjeve kryesisht ne sezonin veror. Perllogaritja e ketij fondi ka per baze tonazhin te realizuar faktik dhe cmimit/ njesi pej 22 $ te negociuar dhe kontraktuar me Bajkaj Land sh.a.

Grafikisht shpenzimet per programin "Sherbime Publike"



***Arsimi ne perberje ka 3 programe*;**

iv.Programi 9120 **"**Arsimit parashkollor",

Ne kete program perfshin kopeshtet, cerdhet, shpenzimet per personelin mesimor dhe ate mbeshtetes, shpenzimet per mirembajtjen dhe rikonstruksion e ndertesave per kete funkion. Buxheti financohet nga transferta e pakushtezuar sektoriale ne 31 % dhe 69% me fondet e veta te Bashkise. Fondin per shpenzime operative dhe mirembajtje financohen teresisht nga bashkia me te ardhurat e veta.

Totali i Buxhetit per vitin 2026 per kete program eshte parashikuar ne shumen **224, 789** mije lek dhe ze rreth 11 % te buxhetit te vjetor.

- 111,623 mije lek nga transfertat e pakushtezuara.
- 101,256 mije lek nga te ardhurat e veta te bashkise.

Keto fonde sigurojne funksionimin e arsimit parashkollor dhe mirembajtjen e infrastruktures asimore me ngrohje, ndricim, uje, tel, internet etj. Per investimet ne institucionet arsimore jane parashikuar **57,240 mije lek** qe konsiston ne rikontruksion total te nje pjese te mjediseve te arsimit parashkollor.

Shpenzimet per pagat te parashikuara per kete program eshte 158,930 mije lek me rritje ne 35 % ne raport me vitin 2025. Nga transferta sektoriale financohen 78 punonjes, edukatore te arsimit parashkollor dhe punonjes mbeshtetes te arsimit parashkollor dhe parauniversitar dhe QKF-ne, me fond pagash dhe sigurime shoqerore ne shumen 138,157 mije lek**.** Shpenzimet operative, kancelari, material pastrami, denzifektime, ushqime, mirembajtje, dhe shpenzime te tjera financohen nga buxheti vendor.

Ne administrim te Bashkise Sarande jane 9 kopeshte dhe 2 cerdhe ku shpenzimet operative ne jane parashikuar ne vleren 30,190 mije lek.

v. Programi 9230 Arsimit parauniversitar

Ne kete program pershihet arsimi i mesem i pergjithshem. Financimi per pagat dhe sigurimet shoqerore per mbeshteses behet nga transferta e pakushtezuar specifike ne vleren **5,478 mije** lek dhe **1,790 mije lek** dhe buxheti per shpenzimet operative financohen nga te ardhurat e bashkise.

vi. Programi 3280 i "Mbrojtja nga zjarri",

Si funksion i deleguar, PMNZSH eshte nje njesi ne varesi te pushtetit vendor me nje buxhet vjetor prej **28,670 mije lek**. Ka transferuar te gjitha kopetencat dhe detyrimet ne Bashki prej vitit 2015 me nje personel prej **17** punonjesish kryen funksionet e shpetimit nga zjarri dhe operacione te tjera qe kane te bejne me sigurine e njerzve. Per plotesimin e nevojave shtese per mjete dhe materiale ne funksion te operacioneve te shpetimit, financimi behet nga buxheti i bashkise.

vii**.** Programi 4260 "Administrimi i pyjeve"

Eshte funksion i deleguar ne Bashki me kryerjen e reformes territoriale. Fondi per kryerjen e funksionit te ketij programi per vitin 2026 eshte 3,782 mije leke per fond pagash dhe shpenzime operative qe kane te bejne me rehabilitim kanalesh ujitese dhe kulluese ne tokat bujqesore dhe te tjera masa qe qe merren per parandalimin e permbytjeve.

viii. Programi 8130 "Qendra kulturore dhe shume sportet"

Ky program financohet nga buxheti i Bashkise dhe funksionon si njesi e varesise me strukture prej 23 punonjesish, pergjithsisht specialist te fushes dhe punonjes mbeshtetes. Institucioni mbeshtet artin dhe zhvillimin e sporteve ne teresi ne funksion te jetes kulturore dhe artistike ne qytet. Ne mbeshtetje te zhvillimit te qendres per vitin 2026 parashikimi i buxhetit eshte ne vleren 74,478 mije lek ku 51% e ze zeri i investimeve kapitale .Nderkohe Qendra Kulturore do te jete ne mbeshtetje te aktiviteteve kulturore dhe artistike pergjate eventeve qe Bashkia ka ne kalendarin vjetor te aktiviteteve . Fondet e parashikuara per mirembajtjen e asateve sportive kane per qellim ruajtjen dhe mbajtjen e mjediseve sportive, pjese e aseteve te publike te Bashkise.

- Bashkia parashikon edhe buxhetim per disiplinat sportive qe ushtrohen nga te rinjte ne emer te shoqatave, sipas ligjeve dhe rregulloreve per sportin ne fuqi, ne vleren 24,000 mije lek.

ix. Programi 10430 " Kujdesi shoqeror per familjet dhe femijet"

" Shtepia e femijes "Vangjel Pulla".

Nga te ardhurat e vendore Bashkia mbeshtet shtepine e femijes me nje fonde per shpenzimet korrente dhe fonde per investime ne funksion te permiresimit te kushteve dhe ambienteve argetuese per femijet. Per vitin 2024 eshte parashikuar fond per shpenzimet e femijeve jorezidente ne vleren 500 mije lek.

"Kujdesi social per shtresa ne nevoje ", (Qendra Polivalente).

Ne buxhetin e bashkise parashikohen fonde shtese per te mbeshtetur qendren polivalente qe funksionon me buxhetim nga buxheti i shtetit. Per vitin 2025 fondi i parashikuar do te jete vitin 4,643 mije lek per te financuar personelin shtese me fond pagash , dhe te tjera nevoja qe ka qendra te nevojshme per funksionimin normal.

Qendra multifunksionale per trajtimin e femijeve.

Qendra funksionon si nje institucion qe funksionon si pjese e struktures se administrates se Bashkise ne funksion te mbeshtetjes dhe trajtimit te specializuar te femijeve me aftesi ndryshe. Bashkia financon te plote buxhetin qe nevoitet ne mbeshtetje te funksionimit optimal dhe efikas ne ndihme te femijeve me aftesi ndryshe te trajtuar ne kete qender. Qendra frekuentohet rregullisht nga 20-30 femije. Struktura per punonjesit eshte planifikuar te jete 10 punonjes kryesisht edukatore dhe punonjes te specializuar per femijet dhe punonjes mbeshtetes.

Si pjese e kesaj qendre prej vitit 2022 eshte hapur edhe nje funksion tjeter me fokus femijet nga familje me perobleme sociale. Qellimi dhe objektivat e hapjes se qendres eshte te ndihmoje femijet per edukimin e tyre nepermjet orarit te studimit ne qender, te shoqeruar edhe me trajtimin me ushqim. Fondi pagave, shpenzimet korrente dhe te tjera shpenzime per investime do te financohen ng ate ardhurat e vet ate bashkise.

"Kujdesi social per PAK dhe NE"

Ne kete program perfshihen te gjitha fondet qe kane te bejne me transfertat ne familjet apo individe per paaftesi dhe trasfertat si ndihme ekonomike qe behen per familjet ne nevoje te klasifikuara nga sherbimi social, ne baze te kritereve qe percaktojne ligjet dhe udhezimet perkatese. Ne buxhetin e vitit 2026 fondi i parashikuar per kete program eshte 244,000 mije lek. Nga Buxheti i shtetit trajtohen 1,893 persona me aftesi te kufizuara dhe rreth 200 familje ne nevoje me ndihme ekonomike.


Nga buxheti i Bashkise jane parashikuar 10,500 mije lek te cilat jane ne dispozicionper rastet emergjente te dhunes ne familje si edhe per financim te shtresat ne nevoje;

x. Programi 9240 "Konvikti i shkolles se mesme profesionale"

Ne funksion te arsimit te mesem profesional me objekt stuudimi "hoteleri dhe turizem" ky program financohet nepermjet transfertes se pakushtezuar sektoriale me nje fond prej 20,897 mije lek per vitin buxhetor 2026. Ne administrim te Bashkise konvikti akomodon dhe kujdes nxenesit e shkolles se mesme profesionale "Antonio Athanas". Fondi eshte i parashikuar per paga dhe sigurime shoqerore per stafin prej 12 punonjes ne 52% te buxhetit , dhe shpenzime operative, 48% te buxhetit. Prej vitin 2021 nxenesit frekuentojne konviktin pa pagese, iniciative kjo e Bashkise dhe Keshillit te Bashkise per te krijuar kushte lehtesuese nxenesve qe frekuentojne keto shkolla.
Ne tabelen e meposhtme pasqyrohen shpenzimet sipas programeve per periudhen 2026-2028;

Kodi	Funksionet	Plan 2026				Plan 2027				Plan 2028			
		shpenzime personeli	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	**Totali Shpenzimeve**	shpenzime personeli	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	**Totali Shpenzimeve**	shpenzime personeli	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	**Totali Shpenzimeve**
1110	Planifikim,menaxhim, Administrim	248,462	237,428	53,260	**539,150**	273,308	250,445	111,126	**634,879**	276,041	257,978	213,004	**747,023**
3280	Shërbimi I mbrojtjes ndaj zjarrit	22,502	6,168		**28,670**	22,502	6,168	9,638	**38,308**	22,727	6,230	9,638	**38,595**
4240	Ujitja dhe kullimi,bujqesia	2,567	5,291		**7,858**	2,567	5,291	-	**7,858**	2,593	5,344	-	**7,937**
4260	Administrimi Pyjeve	3,618	164		**3,782**	3,618	164	-	**3,782**	3,654	166	-	**3,820**
4520	Infrastruktura dhe Transporti Rrugor	-		559,009	**559,009**	-	-	229,651	**229,651**	-	-	346,030	**346,030**
5100	Menaxhimi I Mbetjeve	-	201,024	-	**201,024**	-	201,024	-	**201,024**	-	203,034	-	**203,034**
6260	Sherbime Publike Vendore	112,800	55,580	20,180	**188,560**	112,800	55,580	18,000	**186,380**	113,928	56,136	18,000	**188,064**
6370	Ujesjelles, Kanalizime	-		5,090	**5,090**	-	-	5,090	**5,090**	-	-	5,090	**5,090**
8130	Programe Kulturale & Sporti	29,408	8,980	36,090	**74,478**	29,408	8,980	270,000	**308,388**	29,702	9,070	130,000	**168,772**
9120	Arsimi parashkollor	137,059	30,490	57,240	**224,789**	137,059	30,490	59,000	**226,549**	138,429	30,795	52,000	**221,224**
9230	Arsimi i mesem i pergjithshem	4,434	2,834	-	**7,268**	4,434	2,834	-	**7,268**	4,478	2,862	-	**7,341**
9240	Arsimi i mesem profesional	10,573	10,324	-	**20,897**	10,573	10,324	-	**20,897**	10,679	10,427	-	**21,106**
10430	Shërbimi Social & ndihma ekon.t'ardh veta	3,443	1,700		**5,143**	3,443	1,700	-	**5,143**	3,477	1,717	-	**5,194**
Totali		574,865	559,983	730,869	**1,865,717**	599,712	573,000	702,505	**1,875,216**	605,709	583,759	773,762	**1,963,229**

Paraqitja grafike sipas programeve buxhetore per vitin 2026;



B.3) Shpenzimet per Investime Kapitale

Për vitin 2026 fondit për shpenzime kapitale është në shumën 730,869 mije lek dhe zë 39 % ne raport me totalin e shpenzimeve. Per vitin 2027 parashikimi per investimet eshte parashikuar 726,295 mije lek, dhe per vitin 2028 eshte parashikuar ne vleren 797,788 mije lek. Tabela më poshtë paraqet fondin e shpenzimeve kapitale për vitet 2026 - 2028, sipas programeve buxhetore:

Ne strukturen e investimeve, peshën më të madhe te shpenzimeve kapitale e zene shpenzimet për programet e, Arsimit, Rruget, Urbanistikës, Sherbimeve publike, Bujqesise dhe Strehimit Social.

Financimi nga te ardhurat e veta te Bashkise eshte burimi kryesor ne programin e investimeve kapitale dhe ka per objektiv ;


- Permiresimin e infrastruktures rrugore duke perfshire rrjetin rrugor, me shtrirje ne te gjitha zonat ne zhvillim, per te siguruar askesim dhe permiresim te cilesise se jeteses ne te gjithe territorin e bashkise. Per projektet e ketij programi jane parashikuar 559,009 mije lek per vitin 2026. Disa nga prioritetet qe jane mbajtur ne vemendje gjate hartimit te Buxhetit jane projekte ne proces te nisura nga viti 2025 si me poshte:
    i. Rikualifikim te rruges turizem - kanal i cukes dhe shtrim te rrugeve ne brendesi te lagjes.
    ii. Rikonstruksion te rrugeve te brendshme ne lagjet 1 dhe 2.
    iii. Rikualifikim te rrugeve te brendshme ne lagjen 3.
    iv. Rikualifikim te hapesirave ne bllok banimi ne lagjen 4..
    v. Ndertim trotuare , rikualifikim i rrethimeve anesore ne rruget e brendshme dhe rikualifikim hapsirave shplodhese Ksamil
    vi. Shtrim te rrugeve te brendshme dhe permiresim te ndricimit publik ne Gjashte, Metoq, Cuke, Berdenesh dhe Manastir.
- Studim projektime ne vleren 10,000 mije lek.
    i. Plane te detajuara vendore, per ti hapur rruge zhvillimit te territorit te bashkise.
    ii. Hartim projektesh te rendesishme per zhvillimin strategjike te Sarandes.
- Sherbime Publike ne vleren 20,000 mije lek
    i. Sinjalistika vertikale dhe horizontale
    ii. Rrethimi I varrezave te Cukes,Gjashte,Sarande etj
- Investime ne Arsim , Kulture dhe Art ne vleren 57,240 mije lek
    i. Rikonstruksion te ambienteve ne kopeshtet 2 dhe 3
    ii. Rikonstruksion te shkolles 9 vjecare Cuke
    iii. Rikonstruksion te kopeshtit Ksamil
    iv. Rikonstruksion Kopeshte dhe Shkolla ne Berdenesh, Metoq, Gjashte, Shelegar, Sarande.
- Investime ne permiresimin e dhe KUZ ne Gjashte dhe Sarande, vleren 5,090 mije lek

Tabela me listen e projekteve per vitin 2026

Nr	Emertimi i projektit te investimit	Parashikimi per vitin 2026		
		Vlera e plote e projekteve	Periudha e Financimit	
			V 2026	V 2027
	TOTALI	1,318,764	731,869	564,561
	Administrim, Planifikim Menaxhim	59,170	53,260	5,910
1	Rikonstruksion I zyrave te njesise Administrative Ksamil	5,090	5,090	
2	Blerje paisje kompjuterike	2,000	2,000	
3	Berje mjeti transporti Pol Bashkiake	4,000	4,000	
4	Ndertim zyrash per NSHP ne Volloder	48,080	42,170	5,910
	RRJETI RRUGOR RURAL	785,904	560,009	203,561
5	Ndertim trotuare , rikualifikim i rrethimeve anesore ne rruget e brendshme dhe rikualifikim hapsirave shplodhese Ksamil	89,910	84,910	5,000
6	Rikualifikimi I rrugeve te brendshme dhe shesheve Gjashte , Metoq	49,920	29,920	20,000
7	Rikualifikim i rrugeve te brendshme zona Turizem -Kanali Çukes	45,920	19,850	20,000
8	Rikualifikim i rrugeve te brendshme ne Lagjen ``Baba Rexhepi``	24,920	24,920	
9	Rikualifikim trotuari , K.U.B.- se, ndricim dhe shtresave rrugore ne rruget ``Onhezmi`` dhe ``Lefter Talo``	130,160	90,160	40,000
10	Rikualifikim i rrugeve te brendshme ne Lagjen ``Lugu i Dardhes``	24,920	14,920	10,000
11	Rikualifikimi i rrugeve te brendshme dhe shesheve Berdenesh	29,920	18,359	11,561
12	Rikualifikimi i rrugeve te brendshme dhe shesheve Cuke , Manastir	9,920	9,920	
13	Rikualifikim I rrugeve te brendshme zona Turizem-Kanali Çukes(vazhdim)	25,000	25,000	
14	Rikualifikim I rrugeve te brendshme Lagjia 1 dhe 2	20,000	3,736	
15	Rikualifikim I rrugeve te brendshme Lagjia 3	20,000	20,000	
16	Rikualifikim I hapsirave te brendshme ne bllok banimi ne lagjen nr.4	50,090	30,090	20,000
17	Ndertim pedonale segmenti rrugeve ``DEA - ISADORA DUNKAN - ALIDA HYSKU`` , Ksamil	80,090	50,090	30,000
18	Rikualifikim rruge dhe sheshe Gjasht , Metoq, Berdenesh , Çuke , Manastir	20,000	20,000	
19	Riveshje shtresa asfaltike ne territorin e Bashkise	18,000	11,000	7,000
20	Shkallare lidhese lagj nr 3 dhe rikualifikim shkallare prane Portit	22,000	12,000	10,000
21	Ndertim hapesirash te gjelberta dhe kende lojrash ne lagjet 1,2,3,4	20,000	20,000	
22	Rikualifikim I rruges Rilindja Sarande	70,000	40,000	30,000
23	Sinjalistike per Plazhet Publike	22,334	22,334	
24	Studim Projektime dhe plane strategjik	10,000	10,000	
25	Shpronesime	10,000	10,000	
26	Supervizime kolaudime	1,800	1,800	
	INVESTIME NE SHERBIME PUBLIKE	20,180	20,180	-
27	Rrethimi I varrezave te Cukes,Gjashte,Sarande etj	10,090	10,090	
28	Sinjalistika horizontale, vertikale	10,090	10,090	
	INVESTIME NE FFURNIZIMIN ME UJE DHE KANALIZIME	5,090	5,090	-
29	Rehabilitim te rrjetit te KUB dhe KUZ ne Gjashte dhe Sarande	5,090	5,090	
	INVESTIME NE ARSIM	142,330	57,240	85,090
30	Investime ne terrene sportive ne shkolla	30,090	10,000	20,090
31	Rikonstruksion kopeshti 2 dhe 3	30,000	10,000	20,000
32	Rikonstruksion Kopeshte dhe Shkolla ne Berdenesh, Metoq, Gjashte, Shelegar, Sarande	60,080	20,080	40,000
33	Rikonstruksion kopeshti Ksamil	7,080	7,080	
34	Shkolla 9 vjecare Cuke (catia , fasada , ambjenti jasht)	15,080	10,080	5,000
	INVESTIME NE KULTURE DHE ART	306,090	36,090	270,000
35	Blerje skene,led wall	5,800	5,800	
36	Shpenz per paisje elektronike te QK	200	200	
37	Rikonstruksion i Kinoteatrit	300,090	30,090	270,000
	Shuma	1,318,764	731,869	564,561
	Investime te mbartura			
	TOTALI	1,318,764	731,869	564,561

Ne tabelen e meposhtme pasqyrohen parashikimet afatmesme 2026-2028 te fondeve per investime kapitale per cdo program buxhetor.

Emri i Artikullit	Emri I Programit	Emri I Projektit	Plani 2026	Plani2027	Plani2028
1110	Planifikim, Administrim Menaxhim	Investime me fonde te brendshme	53,260	111,126	213,004
	Total 1110		53,260	111,126	213,004
3280	Sherbimi zjarrfikes	Investime me fonde te brendshme		9,638	9,638
	Total 3280		-	9,638	9,638
4520	Rrjeti rrugor Rural	Investime ne infrastrukturen rrugore	132,790	-	346,030
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikim I hapsirave te brendshme ne bllok banimi ne lagjen nr.4	30,090	20,000	
4520	Rrjeti rrugor Rural	Ndertim pedonale segmenti rrugeve ``DEA - ISADORA DUNKAN - ALIDA HYSKU`` , Ksamil	50,090	30,000	
4520	Rrjeti rrugor Rural	Ndertim trotuare , rikualifikim i rrethimeve anesore ne rruget e brendshme dhe rikualifikim hapsirave shplodhese Ksamil	84,910	5,000	
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikimi I rrugeve te brendshme dhe shesheve Gjashte , Metoq	29,920	20,000	
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikim i rrugeve te brendshme zona Turizem - Kanali Çukes	19,850	20,000	
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikim i rrugeve te brendshme ne Lagjen ``Baba Rexhepi``	24,920	-	
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikim trotuari , K.U.B.- se, ndricim dhe shtresave rrugore ne rruget ``Onhezmi`` dhe ``Lefter Talo``	90,160	40,000	
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikim i rrugeve te brendshme ne Lagjen ``Lugu i Dardhes``	14,920	10,000	
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikimi i rrugeve te brendshme dhe shesheve Berdenesh	18,359	11,561	
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikim I rruges Rilindja Sarande	40,000	30,000	
4520	Rrjeti rrugor Rural	Riveshje shtresa asfaltike ne territorin e Bashkise	11,000	7,000	
4520	Rrjeti rrugor Rural	Shpronesime per projekte	10,000		
4520	Rrjeti rrugor Rural	Shkallare lidhese lagj nr 3 dhe rikualifikim shkallare prane Portit	12,000	10,000	
	Total 4520		559,009	203,561	346,030
6260	Sherbime publike Vendore	Investime me fonde te brendshme	20,180	18,000	18,000
	Total 6260		20,180	18,000	18,000
6370	Furnizimi me ujë,KUZ.	Investime me fonde te brendshme	5,090	5,090	5,090
	Total 6370		5,090	5,090	5,090
8130	Programe Kulturore dhe sporti	Investime me fonde te brendshme	6,000	-	80,000
8130	Programe Kulturore dhe sporti	Rikonstruksioni I Kinoteatrit	30,090	270,000	50,000
	Total 8130		36,090	270,000	130,000
9120	Arsimi Parashkollor	Investime me fonde te brendshme	27,160	25,000	52,000
9120	Investime ne terrene sportive ne shkolla	Investime me fonde te brendshme	10,000	20,090	
	Arsimi Parashkollor	Rikonstruksion Kopeshte dhe Shkolla ne Berdenesh, Metoq, Gjashte, Shelegar, Sarande	20,080	40,000	
	Total 9120		57,240	85,090	52,000
	TOTALI	**Te ardhurat e veta**	**730,869**	**702,505**	**773,762**



BILANCI I PERGJITHSHEM (Te ardhura – Shpenzime)

Nr	Emertimi i të Ardhurave Tatimore	Parashikimi			
		v 2025	v 2026	v 2027	v 2028
I	Te ardhurat e veta	815,131	923,469	976,123	1,046,023
a	**Te ardhura nga Taksat**	**547,036**	**635,602**	**677,779**	**736,139**
1	**Taksat vendore**	**496,036**	**580,078**	**619,510**	**672,763**
	Tatim thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël	600	1,000	1,000	1,000
	Taksa mbi Ndërtesat	142,675	165,146	180,100	196,399
	Familiare	*54,975*	*75,146*	*85,100*	*100,399*
	Biznese	*87,700*	*90,000*	*95,000*	*96,000*
	Taksa mbi token bujqësore	8,981	6,000	6,000	6,000
	Taksa e fjetjes në hotel	68,000	78,200	85,238	92,772
	Taksa e ndikimit në infrastrukture	150,800	175,000	180,000	196,063
b	**Të ardhura nga tarifat**	**232,595**	**252,967**	**264,445**	**276,485**
	Tarifa për pastrim + gjelberim	200,895	216,967	227,815	239,206
	Familiare	93,100	95,500	98,400	109,065
	Biznese	107,795	121,467	129,415	130,141
	Tarifa pyje-kullota, shërb.zjarrfikës,leje tran.	6,480	3,000	3,000	3,000
	Tarifa parkimi/transporti	6,680	12,000	12,000	12,000
	Tarife për shërbime te tjera administrative	18,540	21,000	21,630	22,279
c	**Të ardhura te tjera**	**35,500**	**34,900**	**33,900**	**33,400**
	Shitje Troje e pasuri	3,500	3,000	2,000	1,000
	Qera të aseteve vendore	7,000	6,300	6,300	6,300
	Te ardhura nga gjobat	4,000	7,500	7,500	7,500
	Tarife për shërbime sociale (arsim parash.çerdhe, konvikte)	8,800	9,000	9,000	9,500
	Sporte dhe kultura,muzeumet,	700	200	200	200
	Sponsorizime	7,000	8,000	8,000	8,000
	T'Ardhura nga vitet e kaluara	4,500	900	900	900
	Shuma nga taksat dhe tarifat e Bashkise	815,131	923,469	976,123	1,046,023
2	**Transfertat e pakushtezuara**	**447,957**	**492,248**	**509,093**	**527,206**
	Transferta e Pakushtëzuar	256,673	290,100	306,945	325,058
	Transferta e pakushtezuar sektoriale	146,084	161,148	161,148	161,148
	Transferta e pakushtezuar per mbetjet	45,200	41,000	41,000	41,000
	Shuma	**1,263,088**	**1,415,717**	**1,485,216**	**1,573,229**
3	Te ardhurat te trasheguara nga viti i kaluar	390,000	450,000	390,000	390,000
	TOTALI TE ARDHURAT	**1,653,088**	**1,865,717**	**1,875,216**	**1,963,229**

II	**SHPENZIMET**				
a	**Shpenzime korente**	**1,048,411**	**1,134,848**	**1,172,711**	**1,189,467**
1	Personeli (Paga dhe sig.shoqerore)	517,695	574,865	599,712	605,709
2	Shpenzime operative dhe mirembajtje	476,183	503,900	519,097	529,856
3	Transferta ne individe	49,533	51,083	48,903	48,903
4	Fondi rezerve, Kontigjenca	5,000	5,000	5,000	5,000
b	**Shpenzime Kapitale**	**604,677**	**730,869**	**702,505**	**773,762**
	TOTALI SHPENZIMET	**1,653,088**	**1,865,717**	**1,875,216**	**1,963,229**

Pergatiti:

Drejtoria Ekonomike	Teuta Stroka
Drejtoria e Projekteve	Martion Zhupa
Drejtoria Juridike	Garufo Koka
Drejoria e Planifikimit te Territorit	Zenel Bajrami
Drejtoria e Taksave dhe Tarifave	Elvi Dalanaj
Drejtoria e Sherbimeve	Jolio Dine